REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 20/09 2019 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 - | 400 - | 55473 - | |


**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

**KOMUNA DRENAS**
OPSTINA DRENAS
THE MUNICIPALITY OF DRENAS

SHQIPET E DRENICËS

Duke u bazuar në nenin 5, 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, mbi Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), dispozitave të Statutit të Komunës së Drenas-it 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Rregullorës MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Vendimit Nr. 400/01-31376 të datës 18.07.2019, Kryetari i Komunës së Drenas-it, lidhë këtë:

## MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT PËR FINACIM

**E hartuar me datën : 19.09.2019 e lidhur mes palëve:**

1. **Komuna e Drenasit** - përfaqësuar nga **Ramiz Lladrovci**–Kryetar i Komunës ( në tekstin e mëtejmë **Komuna** ) dhe

2. **OJQ "Shqipet e Drenicës" me seli në Drenas,** përfaqësuar nga përfaqësuesi **Gentrit Mulaku** , me nr. personal 12318334202 nga Komorani, Komuna e Drenasit (në tekstin e mëtejmë **Përfituesi).**

### Neni 1.
### Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje të mirëkuptimit është mbështetja me mjete financiare të **OJQ "Shqipet e Drenicës"**, në implementimin e projektit " **Organizimin e festivalit për fëmijë me nevoja të veqanta " DRENASI FEST 2019"**, ky festival ka karakter garues ku do të ndahen shumë qmime, me qellim të argëtimit të fëmijëve me nevoja të veqanta performojnë këngëtar e valltarë të shumtë.

### Neni 2
### Obligimet e Komunës

**2.1** Komuna do të ndajë mjete financiare buxhetore nga fondi për trasfere dhe subvencione në shumën prej **500 (peseqind Euro)** në emër dhe llogari të **OJQ "Shqipet e Drenicës"- përfitues , transferi bëhet perms xhirollogarisë 1952000266031116 në BKT- Banka Kombëtare Tregtare- Dega në Drenas,** në bazë të vendimit të Kryetarit, 06 Nr.400/01-31376 të dt. 18.07.2019.

**2.2** Komuna do të bëjë pagesën nga paragrafi paraprak, në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

R.h.l

**2.3** Komuna do të monitoroj procesin e shfrytëzimit të mjeteve dhe destinimin e tyre, do të caktoj menaxherin e projektit me vendim të vecantë, Përfituesi i raporton zyrtarit monitorues në baza të rregullta lidhur me zbatimin e projektit sipas kërkesave të kësaj marrëveshje.

**Neni 3**
**Obligimet e Përfituesit**

**3.1** Përfituesi do t'i shfrytëzoj mjetet financiare nga kategoria ekonomike për transfere dhe subvencione për qellimin e caktuar sipas planit të shpenzimeve të paraqitura me shkrim nga ana e përfituesit.

**3.2** Përfituesi do të raportojë në Komunë për shpenzimet e mjeteve të përfituara, në afat prej 45 ditësh pas përfundimit të projektit.

**3.3** Përjashtimishtë, nëse afati nga pika paraprake për shkak të natyrës është i zbatueshëm, me arsyetim të përfituesit ky afat mund të zgjatet për aq kohë të arsyeshme sa do të nevojitet për realizim të projektit.

**Neni 4**
**Raportimi me shkrim**

Përfituesi , në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të Komunës merr për obligim që pas përfundimit te të gjitha procedurave dhe realizimit të projektit të lartëcekur te përgatitin **raport me shkrim financiar dhe narrativ** për Komunën e Drenasit, ne total për mjetet e financimit për realizimin e projektit.

**Neni 5**
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje do të jetë valide dhe e plotëfuqishme deri në përmbushjen e obligimeve të lartëcekura nga të dyja palët.

**Neni 6**
**Zgjidhja e marrëveshjes**

Në rast të mos përmbushjes së obligimeve të parapara në këtë marrëveshje, kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë- Dega në Gllogoc.

**Neni 7**
**Numri i kopjeve**

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit është përpiluar në një ekzemplar për secilën palë dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

P A L Ë T   N Ë   M A R R Ë V E SH J E

| | |
|---|---|
| *Kryetari i Komunës* | *Përfaqësuesi i OJQ "Shqipet e Drenicës"* |
| *Ramiz Lladrovci* | *Gentrit Mulaku* |